



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 3 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 (“Gazeta zyrtare e RK-së” nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të rregullt, e mbajtur më datën 11.03.2026, merr këtë:

VENDIM NR.07/2026/KG
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LIDHJEN E NDRYSHIMIT DHE PLOTËSIMIT TË
SHTOJCËS D TË KONTRATËS NR.2345/23 TË DATËS 01.06.2023 PËR OFRIMIN E
SHËRBIMEVE

Neni 1

Jepet pëlqimi për lidhjen e ndryshimit dhe plotësimit të Shtojcës D të Kontratës nr.2345/23 të datës 01.06.2023 për ofrimin e shërbimeve me kompaninë NKP “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, të përfaqësuar nga u.d. drejtoresha ekzekutive, Sllagjana Mirković (*Slađana Mirković*).

Neni 2

Autorizohet kryetari i Komunës së Graçanicës, Novak Zhivić (**Novak Živić**), që në emër të Komunës së Graçanicës, ta nënshkruajë ndryshimin dhe plotësimin e Shtojcës D të Kontratës nga neni 1 i këtij Vendimi.

Neni 3

Shtojca D e Kontratës për ofrimin e shërbimeve është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.



Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević
Milan Dimitrijević